

Gjendja: Nëntor 2015

Çimkat




Çimkat e rriturra (*Cimex lectularius*)

Shenimet dhe Faktet

çimkat janë insekte që thithin gjakun dhe janë përafërisht 2,5 deri 6 milimetra të mëdha. Ato paraqiten në dhoma të brendshme dhe të banuara dhe njëherit mshefen në vrima dhe vija të hapura të ndryshme, si në mobile dhe në shtretër, njashtu edhe prapa profileve të leftave, tapetave dhe kapakëve të fikësve të dritës etj. Çimkat transferohen në mënyrë pasive nëpërmjet të gjësendeve të ndryshme (bagazhit të udhëtimit, mobileve të përdorura, etj.). Asesi nuk bënë të largohen nga dhomat gjërat të cilat janë vegse kontaminuara me to pa një trajtman të mëparshëm, pasi që ju në atë mënyrë do të shkaktonit një përhapje edhe më të madhe të atyre insekteve. Në qoftë se kemi të bejmë me një kontaminim të rëndë ose në rastet kur çimkave nuk ju qendron në dispoziicion një burim ushqimor është e mundshme që ato të kalojnë në dhoma tjera. Në raste të veçanta mund të vijë edhe deri tek ajo që insektet të qëndrojnë edhe në veshëmbathjen e personave të prekur nga ato dhe në atë mënyrë të përhapen ato insekte edhe më gjërë.

Çimkat me një madhësi origjinale prej ~ 2,5 mm deri ~ 6 mm. 



Pika jashtëqitje të çimkave (majtas) dhe çimka të gjalla në murë (Djathtas)

Çfarë pamje kanë pickimet nga ana e çimkave?

Pickimet nga ana e çimkave mund të kenë pamje të ndryshme me një variacion prej njeriut në njeri. Ekzistojnë njerëz, tek të cilët pickimet e tilla nuk mund të shihen fare,

e ndersa tek të tjerët mund edhe të tregojnë reaksione të forta në lëkurë. Por në mënyrë tipike ato janë të grumbulluara në një grupë me disa pickime të shumta, pasi që çimkat duhet të shpojnë disa hera deri se të jenë në gjendje të thithin në mënyrë të suksesëshme gjakun. Pickimet nga ana e çimkave mund shumë lehtë të ngatërrohen me Pickimet e insketeve tjera. Pickimet e tyre në të shumten e rasteve mund të vërehen në mëngjes, por tek disa njerëz ato edhe mund të pasqyrohen tek se pas disa ditësh.



Reakcionet e ndryshme të lëkurës ndaj pickimeve të çimkave

A kalojnë çimkat patogjenë sëmundjesh?

Jo.

Si duhet të reagoj unë në rast të kontaminimit me anë të çimkave?

Një kontaminim me anë të çimkave nuk ka asgjë të bëjë me një mungesë higjiene, për çfarë arsye edhe nuk mjafton të behet vetëm një pastrim i duhur i dhomave, për të mund menjanuar kontaminimin e tillë. Çimkat nuk mundeni ti luftoni vetvetiu. Luftimi i tyre në shtetin e Gjermanisë realizohet vetëm nga ana e një luftuesi profesional kafshësh dëmtuese. Masat e luftimit ndaj kontaminimeve të tilla në qendrat e grumbullimit të përbashkët janë jashtëzakonisht të vështira dhe konsumojnë shumë kohë. Për atë arsye **informone menjëher administratën e qendres së vendosjes së juaj**, në qoftë se keni vërejtur insekte të tilla të gjalla apo keni vërejtur gjurmët nga ato.

Kontrolloni gjithnjë në mënyrë të rregullt! I shenjzoni gjurmët prezente të jashtëqitjeve të tyre në sipërfaqet e forta, që në atë mënyrë të jeni në gjendje të vëreni menjëher gjurmë të reja të jashtëqitjes së tyre. Vëni mendjen pickimeve. Kontrolloni shtretërit e juaj përkitazi gjurmëve të gjakut. Përcillni udhëzimet e luftuesit të kafshëve dëmtuese.

Udhëzimet (në gjermanisht) në lidhje me dukurin dhe mënyrën e jetesës së çimkave ju mund ti gjeni në këtë faqe: www.biozid.info › Schädlingstratgeber

Botuesie:

Umweltbundesamt

Postfach 14 06 | 06844 Dessau-Roßlau

Tel: +49 340-2103-0 | info@umweltbundesamt.de

Internet: www.umweltbundesamt.de

Burime fotosh: UBA